



IAAP "JONUZ ZEJNULLAHU"-VITI

Nr.protokolit -464

DATA: 08.10.2024

Në bazë Udhëzimit Administrativ të MASHTI Nr.02/2016 për Aktivitete Jashtëshkollore, nenit 11 (pika 1 dhe 2) që rregullon organizimin e ekskursioneve, vendimit të Këshillit Drejtues të Shkollës, drejtoria e IAAP „Jonuz Zejnullahu” në Viti, shpallë këtë:

FTESË PËR OFERTË

Ftojme Agjencitë turistike, të cilat janë të interesuara të ofertojnë për realizimin e ekskursionit të nxënësve maturant për në R.Shqipërisë.

Ekskursioni i planifikuar do të zgjasë 3 netë e 4 ditë dhe është vendosur të realizohet nga data **21 deri 24 Tetor 2024.**

- Numri i nxënësve maturant të regjistruar është 117.

Kushtet që duhet ti plotësojnë ofertuesit:

- Agjencioni të ketë licencë valide, dhe të ketë të drejtë për qarkullim jashtë shtetit
- Të ketë të kryer kontrollin teknik të autobusëve sipas procedurave ligjore dhe teknike
- Të ofroj dëshmi për shëndetin mendor dhe fizik të ngasësve të autobusëve
- Të ketë numër të mjaftueshëm të autobusëve për nevojat e nxënësve
- Autobusët të jenë komfor dhe me klimë
- Agjencioni të mos ketë referenca negative
- Agjencioni duhet të siguroj përkujdesje mjekësore për pjesëmarrësit e ekskursionit gjatë tërë kohëzgjatjes së tij. Ofertës ti bashkëngjiten certifikata e punës, diploma si dhe marrëveshja me mjekun e angazhuar.
- Agjencioni është i obliguar të zbatojë itinerarin e caktuar të ekskursionit.
- Agjencioni ti mbulojë shpenzimet e kujdestarëve të klasëve dhe shpenzimet e vizitave të nxënësve në monumentet kulturo-historike.
- Agjencioni të ketë kontratën (marrëveshjen) për rezervimin e dhomave dhe sistemimin në Hotelin përkatës.
- Dhomat ku vendosen nxënësit të jenë (3 dhe 4 shtretër) si dhe të ketë ujë të ngrohtë 24 orë.
- Agjencioni në bashkëpunim me hotelin të ofrojnë siguri fizike 24 orë për pjesëmarrësit e ekskursionit.
- Të posedojë dokumentacionin (licencën) e agjencionit të akreditimit të ushqimeve për hotelin përkatës.
- Hoteli të ofrojë tre shujta mëngjesin, drekën dhe darken. Ushqimi të jetë i bollshëm dhe kalorik.

Afati i dorëzimit të ofertave është nga data **08.10.2024 deri më 14.10.2024 në ora 15:00 h** dhe të njëjtat, duhet të dorëzohen në DKA - Viti.

